



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.18, datë 05.04.2024

PËR
MIRATIMIN E NDYSHIMIT TË LEJES SË ZHVILLIMIT TË MIRATUAR ME VENDIM
TË KKT NR.25, DATË 10.06.2021 PËR OBJEKTIN: "GODINA HOTELERIE,
SHËRBIMESH, BANIMI 5 DHE 6 KATE, ME 1 KAT PARKIMI NËNTOKË", ME
VENDNDODHJE NË ZONËN PULAJ PLAZH, VELIPOJË, BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Star Plus" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të Lejes së Zhvillimit të miratuar me Vendim të KKT Nr.25, datë 10.06.2021 për objektin: "Godina Hotelerie, Shërbimesh, Banimi 5 dhe 6 kate, me 1 kat parkimi nëntokë", me vendndodhje në zonën Pulaj Plazh, Velipojë, Bashkia Shkodër, me subjekt zhvillues shoqërinë "Star Plus" sh.p.k.,
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin Nr.25, datë 10.06.2021 zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

E DI RAMA

